



HEQJE DORË NGA PËRGJEGJËSIA: Jeni të lutur të vini re se publikimi i tekstit ligjor të mëposhtëm nuk është zyrtar dhe NUK përbën dokument zyrtar të Republikës së Shqipërisë. Konsiderohet thjesht si mjet dokumentimi dhe EURALIUS-i nuk merr asnjë përgjegjësi për përmbajtjen.

LIGJ

Nr. 7501 date 19.7.1991

PER TOKEN

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 7715, datë 02/06/1993)¹

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 7855, datë 29/07/1994)

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 7971, datë 26/07/1995)²

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 8752, datë 26/03/2001)³

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 9244, datë 17/06/2004)⁴

Ne mbështetje te nenit 16 te ligjit nr. 7491, date 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit te Ministrave,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 7715, datë 02/06/1993)

Ne Republikën e Shqipërisë toka ndahet ne:

¹ Ndryshuar më tej me Ligjin Nr. 763, datë 25/10/1993

² Ndryshuar më tej me Ligjin Nr. 8039, datë 23/11/1995; Ligjin Nr. 8074, datë 22/02/1996; Ligjin Nr. 8112, datë 28/03/1996; Ligjin Nr. 8767, datë 05/04/2001; Ligjin Nr. 9064, datë 08/05/2003; Ligjin 9372, datë 14/04/2005; Akt Normativ KM Nr. 3, datë 23/11/2005; Ligjin Nr. 9609, datë 18/09/2006; Ligjin Nr. 9643, datë 20/11/2006; (Ligji i fundit ndryshues është i ndryshuar nga Ligji 9800, datë 10/09/2007; Ligjin 10170, datë 22/10/2009; Akt normativ Nr. 3, 08/07/2010; Ligjin Nr. 22/2012; Ligjin 131/2012; Ligjin Nr. 182/2014; Ligjin Nr. 47/2017)

³ Ndryshuar më tej me Ligjin Nr. 9244, datë 17/06/2004 (Ky ligj është ndryshuar më tej me Ligjin Nr. 69/2013 dhe Ligjin Nr. 131/2014); Ligjin Nr. 10257, datës 25/03/2010; Ligjin Nr. 16/2012; Ligjin 130/2014.

⁴ Ndryshuar më tej me Ligjin Nr. 69/2013 dhe Ligjin 131/2014.

- a) Toka bujqësore te zëna me bimët e arrave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo qe ndodhen, ne fshatra, ne qytete e ne qendra te tjera te banuara, pavarësisht nga madhësia e tyre;
- b) toka te zëna me pyje, kullota e livadhe;
- c) toka jobujqësore: ato te zëna nga ndërtimet ekonomike, social-kulturore, repartet ushtarake dhe oborret e tyre, tokat e zëna nga ndërtimet e banimit dhe oborret (avllitë) e tyre, tokat ne përdorim te përgjithshëm (rrugët, autostradat, aerodromet, varrezat); vende shkëmbore, rërat bregdetare, plazhet; tokat me ujë (liqenet, rezervuarët, hauzet), kanalet e ndryshme, lumenjtë, përrenjtë, zallishtet, kënetat; sheshet e ndërtesave e te monumenteve me interes historik e arkeologjik, si dhe të gjitha tokat e tjera që nuk përfshihen në pikat "a" dhe "b" të këtij neni.

Neni 2

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 7715, datë 02/06/1993)

Shteti u jep toke personave fizike a juridike. Këta gëzojnë te drejtën e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës dhe te gjithë te drejtat qe përmbahen ne kete ligj. Ndalohet shitja dhe blerja e tokës.

Neni 3

Toka bujqësore u jepet ne pronësi ose ne përdorim personave juridike a fizike vendas pa shpërblim.

Neni 3/a

(Shtuar me Ligjin Nr. 7715, datë 02/06/1993)

Pronarët e tokës bujqësore mund t'ua japin atë me qira personave fizikë ose juridikë vendas a të huaj.

Për dhënien me qira të tokës bujqësore, zbatohen dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë kontratën e qirasë".

Neni 4

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 7715, datë 02/06/1993)

(Shfuqizuar me Ligjin Nr. 9244, datë 17/06/2004)

Neni 5

Familjet anëtarë te kooperativës bujqësore, pas ndarjes se tokës kane te drejte te shkëputen dhe te dalin subjekt me vete, duke marre ne pronësi token bujqësore qe u takon nga tërësia

e subjektit ku bëjnë pjese. Sasia dhe vendi ku do te jepet toka, përcaktohet nga komisioni i tokës.

Ne zonat kodrinore e malore, ku familjeve fshatrave nuk u sigurohet sipërfaqja e nevojshme e tokës bujqësore, shteti merr masa dhe u garanton burime te tjera jetese nëpërmjet subvencioneve, shtimit te investimeve për punësimin e njerëzve, vendosjes se asistencës sociale dhe lëvizjes se kontrolluar te popullatës, ne baze te një programi te caktuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 5/a

(Shtuar me Ligjin Nr. 7855, datë 29/07/1994)

Komisionet e Tokave të fshatrave dorëzojnë dokumentacionin e ndarjes së tokës në seksionin e kadastrës të rrethit sipas dispozitave dhe kriterëve të përcaktuara".

Neni 6

Familjeve me banim ne fshat, qe nuk janë anëtarë te kooperativës bujqësore dhe familjeve qe punojnë e banojnë ne ndërmarrjet bujqësore, u jepet ne përdorim toke bujqësore, madhësia e se cilës përcaktohet me vendim te Këshillit te Ministrave.

Neni 7

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 7715, datë 02/06/1993)

Për dhënien e tokës në pronësi ose në përdorim personave juridikë a fizikë, si dhe për mënjanimin e çrregullimeve, krijohen: komisioni qeveritar i tokës pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, komisioni për ndarjen e tokës pranë këshillit të rrethit, ko-misioni i ndarjes së tokës pranë komunës dhe komisioni i ndarjes së tokës pranë fshatit.

Të drejtat dhe detyrat e komisioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".

Neni 8

Ne dhënien e tokave ne pronësi e ne përdorim personave juridike a fizike nuk njihet pronësia e mëparshme, as madhësia dhe kufijtë e saj para kolektivizimit.

Neni 9

Organi shtetëror i specializuar për evidencimin e te dhenve për token është kadastra ne komitetin ekzekutiv te këshillit popullor te rrethit.

Neni 10

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 7715, datë 02/06/1993)

Toka që kalon në pronësi e në përdorim të çdo personi juridik a fizik, regjistrohet në kadastrë. Gjithashtu, në kadastrën e tokave regjistrohet çdo ndryshim i bërë në fakt pas regjistrimit fillestar.

Kur në një fshat ka përfunduar ndarja e tapive të tokës dhe ndonjë person juridik a fizik nuk pranon të marrë tapinë, njoftohet zyrtarisht me shkrim brenda 15 ditëve nga përfundimi i ndarjes së tapive që të paraqitet për ta marrë atë. Në rast se edhe pas një muaji nga dita që ka marrë njoftimin nuk e merr tapinë ose edhe ai që e ka marrë tapinë dhe deklaron me shkrim se e le tokë, e humbasin të drejtën e pronësisë ose të përdorimit mbi të. Në këto raste toka mbetet në dispozicion të shtetit.

Neni 11

(Shfuqizuar me Ligjin Nr. 9244, datë 17/06/2004)

Neni 12

(Shfuqizuar me Ligjin Nr. 9244, datë 17/06/2004)

Neni 13

(Shfuqizuar me Ligjin Nr. 9244, datë 17/06/2004)

Neni 14

(Shfuqizuar me Ligjin Nr. 9244, datë 17/06/2004)

Neni 15

(Shfuqizuar me Ligjin Nr. 9244, datë 17/06/2004)

Neni 16

(Shfuqizuar me Ligjin Nr. 9244, datë 17/06/2004)

Neni 17

(Shfuqizuar me Ligjin Nr. 8752, datë 26/03/2001)

Neni 18

Me miratimin e projekt-ideve dhe te shesheve te ndërtimit nga organet përkatëse, kalon edhe toka ne pronësi ose ne përdorim te atij për te cilin behet ndërtimi, por jo me pare se tre muaj nga fillimi i punimeve. Ndryshimi ne zërin kadastral behet kur fillojnë punimet.

Neni 19

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 7715, datë 02/06/1993)

Toka bujqësore hiqet nga pronësia ose përdorimi i personave juridike a fizike, kur për nevoja te domosdoshme shtetërore bëhen ndërtime te ndryshme dhe veprimtari të tjera ekonomike, sipas miratimit te organit përkatës. Kur për këto nevoja zihen toka qe janë ne pronësi te personave juridike a fizike, shteti është i detyruar t'i zëvendësoje me toke tjetër te barasvlershme dhe ne pamundësi te shpërblehen investimet qe janë bere dhe vlera reale e tokës. Mosmarrëveshjet për masën e shpërblimit zgjidhen nga gjykata.

Neni 20

(Shfuqizuar me Ligjin Nr. 8752, datë 26/03/2001)

Neni 21

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 7715, datë 02/06/1993)

Organet e pushtetit lokal, brenda juridiksionit të tyre, ndalojnë çdo zënie dhe përdorim të tokës në kundërshtim me këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Në rastet e pushtimit, dëmtimit si dhe ndërtimeve të paligjshme nga persona fizikë a juridikë, kryeplaku, komisioni i ndarjes së tokës deri në funksionimin e tij, punonjësi i kadastrës, punonjësi i urbanistikës ligjore e punonjësi i policisë detyrohen të bëjnë denoncim për shkelje të këtij ligji.

Të drejtën e denoncimit për shkeljet e përmendura në këtë nen e kanë edhe pronarët dhe përdoruesit e tokës që e kanë marrë aktin e marrjes së tokës.

Denoncimi bëhet me procesverbal i cili dorëzohet brenda dy ditëve këshillit të komunës ose bashkisë të juridiksionit ku është bërë kundërvajtje.

Këshilli i komunës ose i bashkisë brenda 15 ditëve nga marrja e denoncimit detyrohet të mblidhet dhe të vendosë për:

- a. lirim dhe kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme brenda 3 ditëve;
- b. prishjen e objektit të ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme në tokën e territorit të saj dhe kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme brenda 5 ditëve;

(Shpenzimet për kthimin e tokës në gjendjen e mëparëshme i ngarkohen kundërvajtësit.

Për pikën "a" dhe "b" veprohet kur kemi ndryshim të zërit kadastral si tokë bujqësore.);

c. dënimin me gjobë 5 lekë për metër katror;

ç. dëmshpërblimin për dëmin ekonomik që i ka shkaktuar personit fizik a juridik, të cilit i është dhënë toka në pronësi ose në përdorim.

Kur toka është e pandarë, dëmshpërblimi i jepet bashkisë ose komunës.

Për pikën "c" dhe "ç" veprohet kur kemi zaptim toke që përdoret për qëllime bujqësore.

Vendimi i këshillit të komunës ose bashkisë është i formës së prerë.

Organet e rendit publik të juridiksionit ku veprojnë, detyrohen që brenda 5 ditëve të zbatojnë vendimin e këshillit të komunës ose bashkisë.

(Ndryshuar me Ligjin Nr 7763, datë 25/10/1993) Kur kundravajtësi banon ne juridiksionin e nje rrethi tjetër, ngarkohet për ekzekutimin e vendimit ndaj kundravajtësit organi i percaktuar ne nenin 2 te ketij ligji, i juridiksionit ku banon kundravajtësi.

(Ndryshuar me Ligjin Nr 7763, datë 25/10/1993) Vendimi i keshillit te komunes ose bashkise eshte titull ekzekutiv i formes se prerë.

(Shtuar me Ligjin Nr 7763, datë 25/10/1993) Per ekzekutimin e vendimit te Keshillit te Komunes ose bashkise sipas shkronjes "c" dhe "ç" kur kundravajtësi nuk e derdh vete gjoben, ngarkohet zyra e perbarimit te gjykates se rrethit, e cila brenda 15 diteve te beje ekzekutimin e vendimit.

Neni 22

Kur toka merret, zihet ose dëmtohet nga një person i trete, pronari ose përdoruesi ka te drejte t'i drejtohet gjykatës.

Neni 23

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 7715, datë 02/06/1993)

Personat, qe veprojnë ne kundërshtim me dispozitat e këtij ligji e me dispozitat e veçanta te akteve te Këshillit te Ministrave për kete problem, qe nuk marrin masa mbrojtëse, qe nuk riaftësojnë token ne afatet e caktuara ne kontrate, si dhe qe nuk njoftojnë zyrën e kadastrës brenda afateve për ndryshimet ne gjendjen e tokave ne pronësi ose ne përdorim te tyre pa shkaqe te përligjura, kur këto shkelje nuk formojnë vepër penale, dënohen për kundërvajtje administrative me gjobe nga 2000 - 5000 leke nga përgjegjësi i kadastrës ne rreth.

Kundër vendimit te dënimin mund te behet ankim, brenda 10 ditëve nga shpallja ose njoftimi i tij, te kryetari i komitetit ekzekutiv te këshillit popullor te rrethit, vendimi i te cilit është i formës se prerë.

Personat qe ne kundërshtim me dispozitat ligjore pushtojnë token, e dëmtojnë ose e shpërdorojnë atë ne cilëndo forme qofte, dënohen sipas dispozitave te Kodit Penal.

Neni 23/a

(Shtuar me Ligjin Nr. 7855, datë 29/07/1994)

Komisionet që veprojnë në kundërshtim me nenin 1 të këtij ligji dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore për plotësimin e dokumentacionit të ndarjes së tokës, kur këto veprime nuk formojnë vepra penale, çdo anëtar i komisionit i çdo niveli në vartësi të shkallës të përgjegjësisë, dënohet për kundërvajtje administrative nga 2000 deri 5000 lekë.

Gjobat vendosen nga kryetari i këshillit të rrethit në cilësinë e kryetarit të komisionit të tokave të rrethit.

Vendimi është i formës së prerë.

Neni 24

(Shfuqizuar me Ligjin Nr. 8752, datë 26/03/2001)

Neni 25

Toka bujqësore qe merret ne pronësi sipas këtij ligji, trashëgohet ne baze te dispozitave ligjore për trashëgiminë qe do te miratohen.

Neni 26

Ligji nr. 5686, date 21.2.1987 "Për mbrojtjen e tokës" si dhe te gjithë dispozitat e tjera nënligjore qe bien ne kundërshtim me kete ligj, shfuqizohen.

Neni 27

Ky ligj hyn ne fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Ramiz Alia

Nene të shtuara me ligje ndryshuese

Neni 4

(Shtuar me Ligjin Nr 7763, datë 25/10/1993)

Ministria e Drejtësisë detyrohet të shtojë përmbartuesit për çdo rreth sipas nevojave për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

Neni 3

(Shtuar me Ligjin Nr. 7855, datë 29/07/1994)

Në rast se edhe pas kësaj mase kryetari dhe sekretari i komisionit nuk dorëzojnë dokumentet, denoncohen për ndjekje penale nga komisioni i tokave të rrethit për shpërdorim detyrë.

Neni 17

(Shtuar me Ligjin Nr. 10 257, datë 25/03/2010)

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore, në zbatim të neneve 4, 12 dhe 13 të këtij ligji.

Neni 1

(Shtuar me Ligjin Nr. 10 257, datë 25/03/2001)

Kudo në këtë ligj dhe në aktet e tjera ligjore e nënligjore, emërtimi "Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës" zëvendësohet me emërtimin "Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT)".

Neni 2

(Shtuar me Ligjin Nr. 130/2014)

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 1 të tij.